



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit

Nr. 229 prot.

Pukë, më 16/12 2022

PROJEKT-VENDIM

Nr 03, Datë 16/12/2022

**PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 47 DATË 17.12.2004 PËR EMERTIMIN
E RRUGËVE, SHEHSEVE DHE INSTITUCIONEVE TË BASHKISË
PUKË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 9 nën pika 1.7 shkronja "b" nenit 54, shkronja "II" dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 "për vetë qeverisjen vendore" (i ndryshuar): si dhe neni 2 pika 1 (ç), neni 3, neni 5 pika 1, neni 7, neni 25, neni 26 të ligjit nr.9270, datë 29,07,2004 "Për sistemimin e adresave" (i ndryshuar): Ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", (I ndryshuar), VKB-së nr .74 datë 17.12.2004 "Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe instituconeve të Bashkisë Pukë", me propozim të kryetarit të bashkisë Pukë, Këshillit Bashkiak pasi mori në shqyrtim kërkesën.

Vendosi

1. në pikën 3 VKB-së nr.47, datë 17.12.2004 "Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe instituconeve të Bashkisë Pukë", (shtohet germa gj) Për emërtimin rruge "Aleksander Filipaj" fshati Kçirë në Njesinë Administrative Luf-Qerret sipas fragmentit të hartes bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me piken 1 të këtij vendimi shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipa përcaktimit të ligjit nr.139/2015 "për vetqeverisje vendore" (i ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni I Prefektit Qarku Shkodër.

Hartuesi
Specialis I Zhvillimit Ekonomik
Dhe administrimit të territorit
Pashk Kola

Juristi

Endrit Kraja

KRYETAR

GJON GJONAJ



№ 229/2007

dt. 16.12.2022

RELACION

PËR

**PROJEKT-VENDIMIN PËR NJË SHITESË NË VËNDIMIN NR.47 DATË 17.12.2004
PËR EMERTIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE DHE INSTITUCIONEVE TË BASHKISË
PUKË**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Të nderuar këshilltare/Këshilltarë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) dhe të ligjit nr. 9027/2004 “Për sistemimin e adresave”(i ndryshuar) lind nevoja e emërimit të rrugëve të pa emërtuara në territorin e bashkisë Pukë dhe ndryshimin e disa emërtesave me propozim të banorve të zonës dhe dijeninë e njësisë Administrative, ku një ndër këto rrugë kalon në fshatin Kçirë, lagjija Pla, (sipas fragmentit të hartës bashklidhur).

Për emertimin e kësaj rruge, propozohet emri “Aleksander Filipaj”

Aleksandri lindi me 31.08.1965 në fshatin Kçirë, lagje Pla, shkollën fillore dhe 8-të vjeçare e kreu në Luf, ndërsa shkollene mesme në Pukë, kishte dëshirë të vazhdote studimet e larta por për arsye biografike nuk u lejua.

Në vitin 1885-1986 kreu shërbimin ushtarak në tropojë.

Në vitin 1995-1996 është punësuar në ish komunën Luf-Qerret.

Në bazë të vendimeve nr.299 dhe nr 300 datë 02.03.1997 të këshillit të mbrojtjes kombëtare të kuvendit popullor i është pergjigjur angazhimit të forcave të policisë.

Më datë 05.03.1997 është nisur për Tiranë dhe sipas urdhërit ka shkuar me detyrë në Permet.

Më datë 10.03.1997 është qëlluar më armëzjarri me automatik model (AK-47) nga një person me çrregullime mendore Aleksandëri ishte në detyrë dhe nën uniforme e Policisë.

Nisur nga faktet e sipërcituara kërkojmë nga ju të miratohet Projekt-vëndimi “për një shtesë në vendimin 47 datë 17.04.2004” për emertimin e rrugëve, shesheve dhe instituconeve të Bashkisë Pukë

Ju Faleminderit!

Hartuesi

Specialis I Zhvillimit Ekonomik

Dhe Adminstrimit të Territorit

PASHK KOLA




KRYETARI





GJON GJONAJ



HARTA TREGUESE E RRUGËS SË PROPOZUAR PËR EMËRTIM, ALEKSANDËR FILIPAJ




Legjenda

-  Rruga Nacionale SH5
-  Rruge_rurale
-  Rruge_malore
-  Ndertesa




1 centimeter = 50 meters




Sistemi koordinativ: ERTS 1989, Albanian 2010 (KRGJSH)
 DATUM: ERTS 1989
 Fallsiteti lindor: 500.000
 Fallsiteti verior: 0.000
 Meridiani qendror: 20 grade
 Lartësia origjine: 0
 Njësia: meter





Punoi: exp.GIS Anton Lufi




HARTA TREGUESE E RRUGËS SË PROPOZUAR PËR EMËRTIM, ALEKSANDËR FILIPAJ




Legjenda

-  Rruga Nacionale SH5
-  Rruge_rurale
-  Rruge_malore
-  Ndertesa



1 centimeter = 50 meters



Sistemi koordinativ: ERTS 1989, Albanian 2010 (KRGJSH)
 DATUM: ERTS 1989
 Fallsiteti lindor: 500.000
 Fallsiteti verior: 0.000
 Meridiani qendror: 20 grade
 Lartësia origjine: 0
 Njesia: meter

Punoi: exp.GIS Anton Lufi